

**Workers of all countries, unite!**



**16 Tetori**

**Jan-March No. 12, 2008 Albania today & yesterday**

*Publisher: Dr.Laver Stroka <laverstroka@yahoo.com>*

**Enver Hoxha:**

### **KOSOVA ËSHTË SHQIPËRI**

“Problemi i trojeve shqiptare të Kosovës e i viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi, të aneksuara me forcë Jugosllavisë për ne ka qenë shumë delikat e kompleks. Ne si shqiptarë e komunistë, me ndërgjegje të plotë, coptimin e atdheut tonë e kemi quajtur një padrejtësi shumë të madhe historike. Pa u futur në konsiderata historike të së kaluarës, faktet dëshmojnë se Shqipëria dhe populli shqiptar, me gjithë luftërat e vazhdueshme heroike për të fituar lirinë dhe pavarësinë, fuqitë e mëdha imperialiste dhe fqinjët shovinistë u kanë bërë padrejtësi të mëdha. Shqipërinë e kanë gjymtuar në të gjitha anët e kufijve të saj dhe në rrezik copëtimi ka qenë e gjitha. Toka që i përkasin Shqipërisë, toka që banohej nga shqiptarë, si Kosova, pjesë të Maqedonisë dhe të Malit të Zi iu bashkuan, padrejtësisht, Jugosllavisë së kralëve serbokroatë. Nga çdo pikëpamje që ta marrësh kjo ka qenë e mbetet një e vërtetë e hidhur dhe etnia shqiptare e këtyre trojeve për ne ka qenë dhe mbetet një çështje e padiskutueshme. Serbomëdhenjtë kanë zhvilluar një politikë të egër shoviniste, antishqiptare, në kurriz të shqiptarëve në Jugosllavi, me qëllim që t’i shfarosnin fizikisht e sa për të drejta të tjera as që mund të bëhet fjalë. ...” (Fragment from the book “Kosova is Albania” p. 46, Tiranë 1999)

### **KOSOVA WON THE INDEPENDENCE SHEDING BLOOD RIVERS**

*(Mbi 100 mijë shqiptarë të vrarë dhe të zhdukur brenda shekullit të 20-të)*

**(US, EU Powers recognize Kosova By WILLIAM J. KOLE and NEBI QENA,  
Associated Press Writers)**

PRISTINA, Kosovo - The U.S. and major European powers recognized Kosovo on Monday, a day after the province's ethnic Albanian leaders declared independence from Serbia. Giddy Kosovars danced in the streets when they heard of the endorsements. Kosovo's leaders sent letters to 192 countries seeking formal recognition and Britain, France, Germany and U.S. were among the countries that backed the request. But other European Union nations were opposed, including Spain which has battled a violent Basque separatist movement for decades. "The Kosovars are now independent," President Bush said during a trip to Africa. Secretary of State Condoleezza Rice said Bush "has responded affirmatively" to Kosovo's request to establish diplomatic relations. "The

establishment of these relations will reaffirm the special ties of friendship that have linked together the people of the United States and Kosovo," Rice's statement said. Serbia withdrew its ambassador from Washington over the U.S. decision to recognize Kosovo. As word of the recognition spread, ethnic Albanians poured into the streets of Kosovo's capital Pristina to cheer and dance. The republic's new flag — a blue banner with a yellow silhouette of Kosovo and six white stars representing each of the main ethnic groups — fluttered from homes and offices. But Serb-controlled northern Kosovo was tense with thousands demonstrating against independence and an explosion damaging a U.N. vehicle. No one was hurt. By sidestepping the U.N. and appealing directly to the U.S. and other nations for recognition, Kosovo's independence set up a showdown with Serbia — outraged at the imminent loss of its territory — and Russia, which warned it would set a dangerous precedent for separatist groups worldwide. Russia persuaded the U.N. Security Council to meet in emergency session Sunday in an attempt to block Kosovo's secession. The council was to meet again later Monday. Kosovo had formally remained a part of Serbia even though it has been administered by the U.N. and NATO since 1999, when NATO airstrikes ended former Yugoslav leader Slobodan Milosevic's crackdown on ethnic Albanian separatists, which killed 10,000 people. Ninety percent of Kosovo's 2 million people are ethnic Albanian — most of them secular Muslims — and they see no reason to stay joined to the rest of Christian Orthodox Serbia. Despite calls for restraint, tensions flared in northern Kosovo, home to most of the territory's 100,000 minority Serbs. An explosion damaged a U.N. vehicle outside the ethnically divided town of Kosovska Mitrovica, where thousands of Serbs demonstrated, chanting "this is Serbia!" The crowds marched to a bridge spanning a river dividing the town between the ethnic Albanian and Serbian sides. They were confronted by NATO peacekeepers guarding the bridge, but there was no violence. Another 800 Serbs staged a noisy demonstration in the Serb-dominated enclave of Gračanica outside Pristina, waving Serbian flags and singing patriotic songs. "Our obligation is to stay in our homes and live as if nothing happened yesterday," said protester Goran Arsic. In a first sign that Serbia was attempting to retake authority in the north of Kosovo, some Serb policemen started leaving the multiethnic Kosovo police force on Monday and placed themselves under the authority of the Serbian government in Belgrade, a senior Kosovo Serb police official said, speaking on condition of anonymity because of the sensitivity of the subject. There were about 320 Serb policemen in the U.N.-established force that has run Kosovo since 1999. The departure of Serb policemen in the force would likely trigger a confrontation with the U.N. administration. Kosovo is still protected by 16,000 NATO-led peacekeepers, and the alliance boosted its patrols over the weekend in hopes of discouraging violence. International police, meanwhile, deployed to back up local forces in the tense north. NATO insisted its peacekeeping mission in Kosovo will not be

weakened by differences among the allies over recognition. The 27 EU nations stood divided as their foreign ministers met in Brussels, Belgium, to try to forge a common stance on recognition. At the end of the meeting, the ministers cleared the way for some member nations to endorse independence. European powers France, Britain and Germany led most of the EU nations in recognizing Kosovo. Spain led a group of five who opposed it, fearing it could set a dangerous precedent encouraging separatist minorities elsewhere to seek statehood. "A majority of the EU states will recognize Kosovo," German Foreign Minister Frank-Walter Steinmeier predicted, saying 17 member states were set to do so in the coming weeks. British Foreign Secretary David Miliband said recognizing Kosovo now "can help the western Balkans close two decades of violence and conflict." "There is a very strong head of steam building among a wide range of countries that do see this as the last piece of the Yugoslav jigsaw and don't see stability in the western Balkans being established without the aspirations of the Kosovar people being respected," Miliband said. French Foreign Minister Bernard Kouchner said Kosovo's declaration was "a great success for Europe, a great success for the Kosovars and certainly not a defeat for the Serbs." Italy, Sweden, Belgium, Bulgaria, Finland, Ireland, Austria, Slovenia, the Czech Republic and Poland also said they had initiated national procedures to recognize Kosovo. Spain, however, said Kosovo's independence bid — and efforts to recognize it — were illegal under international law. On Sunday, Kosovo's lawmakers achieved what a bloody 1998-99 separatist war with Serbian forces could not: They pronounced the disputed province the Republic of Kosovo, and pledged to make it a "democratic, multiethnic state." The proclamation sent thousands of jubilant ethnic Albanians into the streets overnight, where they waved red-and-black Albanian flags, fired guns and fireworks into the air and danced in the streets. Kosovo President Fatmir Sejdiu played down the fears of renewed unrest Monday, saying the government needed to set about the business of building a democratic country. "It will be a big day today because we have lots of things that we need to start and finish," Sejdiu said. "We need continuous work and commitment, and we are fully dedicated to fulfilling the promises to better our state." The 192 letters seeking recognition included one to Serbia. But the Belgrade government made clear it would never accept Kosovo's statehood. Serbia said it would seek to block Kosovo from gaining diplomatic recognition and membership in the U.N. and other international organizations. "The so-called Kosovo state will never be a member of the United Nations," Serbian Foreign Minister Vuk Jeremic said. Serbia's Interior Ministry filed criminal charges on Monday against the three Kosovo leaders for proclaiming independence — Sejdiu, Prime Minister Hashim Thaci and parliament Speaker Jakup Krasniqi. The charges were only symbolic because Serbia has not had jurisdiction over Kosovo since the 1999 war. Serbia's government has ruled out a military response as part of a secret "action plan" drafted earlier this week.

But it threatened to recall its ambassadors from all countries that establish diplomatic ties with Kosovo, though it would not cut diplomatic relations. "This decision by the United States will not turn the false state (of Kosovo) a real one," Serbian Prime Minister Vojislav Kostunica told parliament. "The government has ordered the immediate withdrawal of the ambassador from Washington." Russian President Vladimir Putin has argued that independence without U.N. approval would set a dangerous precedent for "frozen conflicts" across the former Soviet Union, where separatists in Chechnya and Georgia are agitating for independence.

### ÇLIRIMTARËT E KOSOVËS MARRIN PËR SIPËR MISIONIN E QEVERISJES

Hashim Thaçi, i ardhur nga shtabi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, pasi deklaroi në Kuvendin e Kosovës shpalljen e krahinës shqiptare në shtet të Pavarur, premtoi se do të mundësojë bashkëjetesën normale të shumicës absolute shqiptare me pakicën sllave, turke etj. Mirëpo kjo nuk i pëlqen Beogradit dhe ka nxitur trazira të përsëritura, që në pjesën veriore të Mitrovicës kanë patur edhe viktime. Shërbimi policor i Kosovës, i përbërë nga ish luftëtarët e UÇK-së ka ruajtur gjakftohtësinë, duke kthyer mbrapsh edhe grupet e huliganëve të nisur prej Serbisë me misione destabilizuese. Akte dhune dhe djegje të ambasadave të huaja perëndimore kanë ndodhur në Beograd pas njohjes së shtetit të ri të botës me emrin Kosovë. Mbështetja ruse për politikën primitive skllavëruese të Serbisë ndaj shqiptarëve të ish-Jugosllavisë i ka inkurajuar forcat regressive konservatore serbe për aktet e mësipërme. Sidoqoftë realiteti në vendin fqinj të Kosovës nuk është njëngjyrësh. Këtë e dëshmon mosmiratimi në Parlamentin Serb të deklaratës së qeverisë së Koshtunicës "për t'u bërë pjesë e bashkimit evropian me Kosovën si pjesë e pandarë e vendit." Kjo çoi edhe në rrëzimin e kësaj qeverie duke shpallur zgjedhjet e reja rreth 3 muaj pas përfundimit të tyre. Komunistët shqiptarë, duke festuar fitoren e shpalljes së pavarësisë së Kosovës, i bëjnë thirrje popullit Serb të tregojë maturi dhe të njohë e respektojë shtetin e ri të merituar të botës. Në anën tjetër e konsiderojnë pavarësinë si një hap të pjesshëm në proçecin e zgjidhjes së problemit kombëtar shqiptar në Mal të Zi, në Serbi, në Maqedoni dhe në Greqi. Në këtë moment të rëndësishëm historik përshëndesim miqtë dhe shokët tanë kudo në botë për mbështetjen e dhënë. Falënderime u drejtojmë Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të Bashkimit European, vendeve të Lidhjes Islamike dhe gjithë atyre që e njohën pa vonesë ose që do të njohin në të ardhmen Kosovën si shtet. Ky qëndrim i tyre kontribon dukshëm në stabilitetin politik në Ballkan dhe në tërë Europën Juglindore.

### BORXHI I JASHTËM KOLONIZON SHQIPËRINË

Shqiptarët këtë fillimviti po përjetojnë varfërinë më të thellë. Një pjesë e mirë kanë humbur çdo shpresë tek sistemi i sotëm kapitalist i cili me forma nga më të ndryshmet të hapura dhe të maskuara po u pi gjakun. Klasa e re e borgjezisë po pasurohet me sakrifikimin e tyre përmes shfrytëzimit të paimagjinueshëm. Gratë dhe fëmijët janë më fatkeqët si më të pambrojturit prej natyre. Po kështu edhe ata me arsim të kufizuar e përjetojnë pothuaj të tillë skllavërimin modern. Të kërcënuar nga uria njerzit detyrohen të punojnë në kushte tepër të vështira në punë të zezë tek firmat vendase dhe ato të huaja që

kanë marrë disa fabrika dhe miniera me koncesion. Helmimet me kimikate në vendin e punës, mbetja në galeri, rrëzimi prej skelave janë raporte gati të parjavëshme në kronikat e zeza mediatike. Të krijohet ideja se shqiptarët janë me qindra miljona duke punuar, jo vetëm disa mijëra. Sikur edhe kjo të mjaftonte do të ishte e bollshme për të vajtuar mjerimin shqiptar. Por shqiptarët kanë edhe detyrime të tjera që u merren nëpërmjet rritjes së taksave dhe formave të ndryshme të imponuara. Vetëm për shlyerje të borxhit të jashtëm secili aktualisht detyrohet 900 \$. Kjo lidhet me politikën e nënshtimit tek padronët e huaj dhe të shkatërrimit të ekonomisë kombëtare që është ndjekur këto dy dekada në vazhdim. Në të tillë pozitë të vendosur qeveritë paskomuniste po e shndrojnë vendin në colonial me vartësi të plotë tek kapitali i huaj. Tani janë ata që vendosin kush do të marrë dhe kush do të dorëzojë pushtetin, ku, si dhe sa do të investosh, ku dhe sa do të punësosh, çfarë do të shesësh dhe çfarë do të blesh, si do të sillesh me qytetarët e tu, sa ushtarë e policë dhe sa armë e municione do të kesh, si do të luftosh dhe kundër kujt. Ja pse qeverisësit dhe politikanët janë vetëm kukulla pas vitit 1990. Ja pse ata mashtrojnë pa të keq e pa u skuqur. Ja pse kapitali perëndimor dhe ai botëror investoi aq shumë për përmbyshjen e sistemit komunist në Shqipëri dhe në Bashkimin Sovjetik: Për të marrë pozitën komanduese që nuk e kishte. Ja pse vjell aq shumë kundër Marksit, Engelsit, Leninit, Stalinit dhe Enverit. Për të bërë politikën siç i intereson atij dhe jo popujve. Prandaj askush nuk duhet të heshtë para këtij realiteti të tillë që ka sjellë dhe do të shtojë fatkeqësitë tek popujt e nënshtuar.

### SHTETI LIGJOR KAPITALIST NJË MASKARADË

Dëshmi të dëmnuarish dhe fakte të sjella nga televizionet dhe shtypi I shkruar janë tepër rënqethëse. “Vrasësi shetit i lirë nëpër qytetet e vendit tonë dhe të Europës.” “Gruaja mbi 70 vjeçe që e ka kërcënuar për vrasjen e djalit të saj kriminelin, qëndron prej vitesh në qeli.” “Vrasësi i 6 personave dënohet me 6 muaj burgim.” “Babai i dy fëmijëve qëndron në qeli i dënuar 7 vjet përrrëmbim të shoqes së vet, ndërsa e shoqja dhe prindërit e saj kërkojnë lirim dhe bahskëshortit dhe dhëndrrit legal.” “Nuk dorëzon 5 000 euro prokurorit, merr ndëshkim maksimal i biri.” “Hajduti pranon krimin e vjedhjes, i ndëshkuari padrejtësisht për këtë krim mbahet ende në burg.” “Endesh me muaj e vite gjyqeve për pasurinë që të ka shitur shteti.” “Mijëra vendime gjyqësore të formës së prerë të paekzekutuar për vite nga përmbarimi.” “Të ndaluarit dhe të burgosurit rrihen deri në vdekje ose degradim psikik.” “Korrupsioni në burge ka përmasa të papara sipas vetë dëshmimeve të punonjësve të këtij sektori.” “Mbipopullimi i burgjeve shqiptare është shqetësim i Ministrisë së Drejtësisë dhe i Avokatit të Popullit, edhe pse numri i tyre është dhjetëfishuar.” Këtë rritje të numrit të burgjeve dhe të të burgosurve e pohon një ish kuadër i lartë i këtij sektori prej kohës së Enverit deri në pak vite të kaluara. I burgosuri përbën një barrë të rëndë për familjen sot ndërsa dje mund të ndihmonte sado pak me të ardhurat që nxirrte duke punuar, sidomos në minierën e Spaçit. Episode të kësaj natyre janë të panumërta në historinë e shtetit kapitalist shqiptar këto 18 vjet. Korrupsionin në drejtësi nuk e pohojnë vetëm viktimat (qytetarët që i ka zënë halli), por edhe presidentët e shtetit dhe kryeministrat që kanë drejtuar vendin në këto dy dekada. Miliarda lekë i janë vjedhur shtetit nga nëpunësit e lartë të të emëruar dhe të zgjedhur në të gjitha nivelet. Megjithatë vetëm ndonjë “cironkë” ka vuajtur diçka simbolike për demin e shkaktuar. “Peshkaqenët” gjithmonë kanë dalë të larë edhe prej komisioneve hetimore parlamentare,

të cilat janë bërë shfaqjet më qesharake. Po dje çfarë ndodhte: Fajtori ndëshkohej. Vetëm rrallëherë mund të ketë ndodhur që personi të ketë marrë ndëshkim jo plotësisht të merituar, duke ju siguruar tërë privilegjet e humbura dhe shpërblimi financiar. Çdo process gjyqësor ishte i detyruar të përfundonte brenda tremujve, ndërsa qendrimi në izolim nuk mund të kalonte nga 72 orë pa ju vërtetuar fajësia. Dhunimi i të ndaluarve dhe personit me liri të humbur nga hetuesit ose policia për të pranuar fajin, ishte i ndaluar me ligj dhe nëse konstatohej një kuadër që e shkelte sadopak ligjin largohej nga detyra duke kaluar punëtor në minierë ose në bujqësi ose në ndërtim. Vuajtësit e djeshëm ishin të detyruar të punonin dhe fitonin duke ulur edhe periudhën e dënimit me sjellje dhe tejkalim të normës.

## **POLITIKA E FATKEQËSIVE DHE E MJERIMIT**

Pas vitit 1990 propaganda e partive politike antikomuniste në vendin tonë e orientoi qytetarin e thjeshtë tek “mrekullitë” e importit duke synuar paralizimin e plotë të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë vendase. Kjo lehtësoi restauratorët e kapitalizmit të aplikonin më lehtë “terapinë e shokut” ose të kalimit në nivelin zero që nuk ishte tjetër gjë veç rrafshimi i veprës 50 vjeçare të klasës punëtoare dhe fsatarësisë kooperativiste. Renegati Ramiz Alia zgjodhi variantin “fshatçe” që do të thoshte bëni batërdinë se shteti as që do të merret më me ju. U prenë dhe u dogjën vreshta, plantacionet me agrume dhe ullinj, mollë, qershi, gështenja, dardhë, fiq, kumbulla, pjeshkë etj. U shkatërruan stallat e bagëtive të holla e të trasha. U shkatërrua sistemi telefonik tokësor, sistemi bonifikues dhe i furnizimit me ujë të pijshëm, u vodhën repertorët e televizionit, makineritë dhe paisjet e ndryshme etj. U mbyllën dhe u degraduan hidrocentralet e vegjël të zonave që plotësonin nevojat lokale. Të njëjtin fat patën edhe sektorët e tjerë të industrisë së lehtë, të rëndë dhe minierat. Në sektorin e mbrojtjes filloi trafiku i armëve. U braktis sektori i kërkimit dhe shfrytëzimit të vendburimeve të naftës. U fol për kostot e ulëta të energjisë së importueshme në të ardhmen dhe i drithërave të bukës etj. Mirëpo kjo propagandë dhe politika ekonomike e ngritur mbi këto orientime krijoi probleme të mëdha sociale si papunësia dhe dyndja drejt emigrimit. Në këtë situatë u krijua mafja e vizave dhe transportimi illegal me skafe ose në rrugë tokësore përmes maleve. Brenda 17 vjetëve u vranë, u mbytën dhe u zhdukën pa asnjë gjurmë mbi 23 mijë persona si foshnja, vajza, djem, gra dhe burra. Kjo politikë që la djerrë mijëra e mijëra hektarë fusha të qenditura në epokën e socializmit, u pasua edhe me ndërtime të panumërta në këto toka buke duke e copëtuar dhe zvogëluar dukshëm sipërfaqen e punueshme më parë. Ndërprerja e punimeve në hidrodcentralin e Banjës në përfundim të rreth 80 % të punimeve hoqi jo vetëm mundësinë e furnizimit me dritë të disa qyteteve, por edhe të ujitjes së rreth 80 mijë hektarëve në fushën e Myzeqesë. Shoqëri fantazma kanë ardhur “për kërkim naftë” dhe marrje me koncesion të disa minierave, fabrikave dhe kombineve. Ato janë bërë kanceri i ekonomisë dhe i jetës së shqiptarëve të punësuar nëpër to. Drithërat e bukës që siguroheshin qysh prej fillimit të viteve '70 të shekullit të 20-të, tani vetëm importohen sëbashku me frutat, perimet dhe karburantet. Gjatë 18 vjetëve rritja e çmimit të këtyre produkteve ka vazhduar në mënyrë të pandërprerë duke i varfëruar si asnjëherë pjesën më të madhe të shqiptarëve. Nëse nuk do të qarkullonin rreth 5 miliardë dollarë të eksportit të drogës Shqipëria do të ishte shndërruar sot më keq se një xhungël. Megjithatë kjo nuk është pasuri e shqiptarëve, por vetëm e një pjese të tyre, duke përfshirë trafikantët, policët

dhe shefat e tyre, gjykatësit, prokurorët, politikanët dhe pushtetarët. Pjesa tjetër ka mbushur listat e borxheve në dyqanet e fshatrave dhe të lagjeve. Këtë realitet e pohojnë me gojën e tyre jo vetëm qytetarët, por edhe pushtetarët e lartë të vendit. Kjo situatë ka kthjelluar një pjesë të mirë të popullatës duke kujtuar me mall Enver Hoxhën dhe sistemin socialist që ndërtoi. Tashmë objektet artistike me fotografitë e tij, disqet muzikore, me fjalime të tij, skulptura dhe shkrimet kushtuar jetës së tij po blihen si asnjëherë. 100 vjetori i lindjes është një rilindje e këtij udhëheqësi të lavdishëm të papërsëritshëm të shqiptarëve. Njerzit kërkojnë një forcë udhëheqëse të besueshme që të ecë në rrugën e projektuar prej Enverit, por ende është herët. Partia e Punës e Shqipërisë e riorganizuar ka marrë këtë mission për sipër dhe me siguri do ta justifikojë emrin që mban. Realizimi i këtij misioni kërkon organizim të mirë, disiplinë të çeliktë dhe sakrificë. Pa këto realiteti i sotëm shqiptar nuk mund të tjetërsohet.

### **MIQ TË PAHARRUAR TË SHQIPTARËVE.**

(Bill Bland, Fred Clements dhe Rex Holl)

*Marsi gjithmonë na sjell në mendje politologun e shquar Bill Bland. Ai ishte një njohës i shkëlqyer i historisë botërore dhe një analist i shkëlqyer i zhvillimeve në rajone e shtete të ndryshme në këndvështrimin Marksist-Leninist. Si kryetar i shoqatës së miqësisë Angli-Shqipëri ai kishte njohuri të hollësishme për shqipërinë socialiste, të cilat i përdorte me zgjuarësi ku deformatohej e vërteta qëllimisht ose prej paditurisë. Kjo ndërhyrje sqaruese përmes mediave të Londrës e kishte bërë të etiketohej si “ambasadori i Shqipërisë” Kam patur fatin ta njoh nga afër këtë njeri të madh që të ngjallte respekt dhe simpati të veçantë. Disa analiza të tij i kam botuar edhe në shtypin partiak duke marrë vlerësime maksimale prej masës së gjerë. Me ndermi ne kujtojmë sot edhe historianin Fred Klement dhe gazetarin Rex Holl nga Zelanda e Re, me të cilët na bashkon lufta revolucionare për të ardhmen e ndritur komuniste. Me ta kam ruajtur korespondencë disavjeçare nga e cila kam kujtime të paharruara dhe përfitime përvojë për luftën politike në kushtet e sistemit të urryer capitalist. Ata me veprën e tyre mbeten jo vetëmiqtë e mi personale, por edhe të popullit dhe të kombit tim, pasi janë shqetësuar dhe interesuar vazhdimisht për fatet e tij të nëpërkëmbura. Të paharruar shokët dhe miqtë tanë shquar Bill Bland, Fred Klements dhe Rex Holl!*

### **STOP TERRORIT FASHIST MBI POPULLIN HEROIK KURD!**

*Aviacioni ushtarak turk dhe mijëra trupa këmbësore të armatosura gjer në dhëmbë since December 16, 2007, started with land attacks on the evening of February 21 një fushatë të gjerë kriminale kundër popullit të Kurdistanit të Jugut me motivin qesharak të shkatërrimit të bazave të rebelëve. While bombs were hailed for weeks on the mountains in South Kurdistan, civil targets, hospitals, schools and villages were also targeted. Ajo është e dënueshme dhe e papranueshme prej gjithë qytetarëve përparimtarë të botës. Jemi të bindur se agresioni nuk do të frikësojë popullin, por do ta bëjë më të ndërgjegjshëm për të farkëtuar unitetin dhe pasuar bijtë e tij që japin shembëllin e vet si mund të fitohet liria. Komunistët e vërtetë ndodhemi shpirtërisht pranë luftëtarëve të pushkës e të penës, pranë viktimave të kësaj lufte çnjerëzore, që kërkon të nënshtrijë një popull dhe komb kryelartë e të pamposhtur. Burgimet, torturat dhe vrasjet makabre të*

*njerëzve që prijnë në aksionet për realizimin e aspiratave të gjera popullore nuk mund të ndalë procesin dialektik historic të çlirimit kombëtar dhe shoqëror, por i bën masat e gjëra më të ndërgjegjshme për misionin revolucionar. Në këto beteja politike dhe ato ushtarake kualifikohen herojtë dhe griset maska e oportunistëve dhe shërbëtorëve të borgjezisë dhe të okupatorit. Kjo çon në përmirësim të drejtimit dhe metodave të luftës revolucionare duke afruar ditën e fitores së madhe.*

### **SOLIDARITY WITH THE 10 SEPTEMBER PRISONERS**

(3000 years of prison demanded for the 10 September prisoners!)

*Some of the 10 September prisoners, among them are journalists, writers and people known to be socialists, are tried to be related to the MLCP and several times lifelong is demanded for 13 of them while the remaining 10 are wanted to be sentenced to different penalties between 10,5 and 45 years. The prisoners did not have the chance yet to read their files as they had been hindered by the prisons administrations' so far after the files were finally open to be read after a long time. Therefore, the prisoners could not defend themselves at court on October 26. However, they exposed and condemned the fascist dictatorship and made speeches defending socialism. Not the revolutionary and communist prisoners, but the capitalist system was sentenced.*

### **HEBRENJTË FALËNDEROJNË SHQIPTARËT**

**(Sikur të gjithë kombet të kishin vepruar si shqiptarët numri i hebrenjve të zhdukur do të ishte i papërfillshëm)**

Mijëra hebrenj të përndjekur prej nazizstëve gjermanë rendën drejt shqipërisë gjatë Luftës së II botërore jo për më shumë mirëqënie, pasi ekonomia këtu ishte shumë më mizerabël seç mund të mendohet, por për të shpëtuar kokën e tyre. Bujaria shqiptare kësaj radhe mund të ndëshkohej rëndë nëse nazistët informoheshin për familjet strehuese. Kontrollat dhe bastisjet e bëra herë pas here për të zbuluar partizanët e plagosur dhe mysafirët në qytetet dhe fshatrat e vendit tonë nuk e frikësonin popullin fukara që i bëri hebrenjtë pjestarë të padallueshëm të familjes. Me dhjetra kujtime, falënderime dhe konsiderata të mirënjohjes për popullin shqiptar janë manifestuar më 27 janar të këtij viti, në ditën e Holokaustit. Në ceremonitë dhe veprimtaritë e organizuara me këtë rast, u shfaq edhe filmi i ri dokumentar me regji të Piro Milkanit dhe Saimir Kubaros, që evidenton historinë e hebrenjve të Shqipërisë. Në këto veprimtari mori pjesë krahas dhjetra hebrenjve edhe ambasadorja e Izraelit në vendin tonë Amira Arnon, e cila midis të tjerash theksoi se "Shteti Izraelit ka vlerësuar familje shqiptare ndër to edhe të Tiranës. Duke nderuar humanizmin tashmë të njohur, këto familje janë dekoruar nga shteti i Izraelit për veprën e tyre humane". Ndër familjet e dekoruara bëjnë pjesë ato të Margarita Kristidhit, Edi Pilkut, Llambi Kasapit, Erika Toptanit, Haki Bulkut, Petrit Veselit, Petrit Kikasit, Myzafer Kazazit, Agim Marikut, Lulëzim Gogjasit dhe Sadik Kalasë. Veprimtari të ngjashme me pjesëmarrje të shqiptarëve të ftuar janë zhvilluar edhe në Izrael.

***Ju lutemi, shperndajeni tek çdo i interesuar!***

**E ardhmja është e jona**